



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-150229

Data: 05.05.2025

**P r i z r e n**

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën e Drejtorise për Shërbime Publike- Komuna e Prizrenit , me të cilën pala ka kërkuar leje për: **“Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen “ Bajram Curr “- Prizren ,** e në bazë të e në bazë të nenit 3 paragrafit 1,pika 1.27 te Ligjit per Planifikimit Hapsinor me Nr.04/L-174 te Dt.31.07.2013,nenit 3.1.1,1.2,1.4,1.17,1.24, e në lidhje me nenin 4,1.2,si dhe nenit 5,1.1 e lidhur me nenin 14.1.4,të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110,si dhe konform nenit 40 alinea 4 dhe nenit 41alinea 1,dhe të nenit 45 e lidhur me nenin 51, dhe sipas konform Vendimit për miratimin e sipas vendimit per miratimin e HZK per peridhen 2022-2030 Nr.001-011-48192 te dt 31.03.2022dhe në harmoni me dispozitat 3.alenia 1 pika1.1,1.3,1.5 dhe 1.5 , dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82.83 e në lidhje me nenin 84.85. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I LEJOHET** - Drejtorise për Shërbime Publike- Komuna e Prizrenit , me të cilën ka kërkuar leje per: “Ndertimin e infrastrukturës në lagjen “ Bajram Curr” -Prizren.

- I.** Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë-Projekti I punuar nga Byroja projektuese “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K.-Prishtina.
- II.** Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III.** Hunjëzimi i objektit të bëhet sipas dokumentacioni teknik..
- IV.** Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime
- V.** Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- VI.** Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës
- VII.** Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VIII.** Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtrrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- IX.** Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.
- X.** Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësimin e dokumentacionin 04-353/01-150229 dt. 25.02.2025
- Pëlqimi nga "KEDS" Sh.A.
- Pëlqimi nga Kom. "Hidroregjioni Jugor",
- Pëlqimi nga Telekom I Kosovës –PTK-ja.

P.S. DSHP gjatë implementimit të projektit merr përsipër për problemet eventuale që mund të dalin lidhur me infrastruktur dhe çështje pronësore juridike duke bërë zgjidhje sa më të mire të mundshme.

## **A r s y e t i m**

**Drejtoria e Shërbimeve Publike - Komuna e Prizrenit , me të cilën pala ka kërkuar leje për: ndërtimin e infrastrukturës në lagjen "Bajram Curr " në Prizren, është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për :**

### **Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen "Bajram Curr " në Prizren .**

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.


Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për :

### **Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen "Bajram Curr " në Prizren .**


Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës MMPHI së-Prishtinë.

**Bashkëpunëtor profesional:**

  
\_\_\_\_\_

**Afërdita Mormorina, inxh.dip.ark.**



**DREJTORI:**

  
Pranverim Berisha, jur.